

Api – Kži – 6/2011  
25 shtator 2012

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, kolegin e përbërë nga gjyqtari i EULEX-it Martti Harsia si Kryetar kolegi dhe gjyqtarja e EULEX-it Anne Kerber dhe gjyqtarët e Gjykatës Supreme të Kosovës Avdi Dinaj, Valdete Daka dhe Shukri Sylejmani si anëtar të kolegit,

Në lëndën penale kundër të pandehurit [REDAKTUE] i dënuar më 27 mars 2009 nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për vrasje të rëndë [neni 147 paragrafi 1 nën-paragrafi 4 dhe 11 i Kodit Penal të Kosovës (KPK)] dhe për mbajtje në posedim, në kontroll, në pronësi dhe në shfrytëzim të paautorizuar të armëve [neni 328 paragrafi 2 i KPK-së]. Më 19 prill 2011 Gjykata Supreme e Kosovës mbështeti dënimin por e ndryshoi atë. [REDAKTUE] u dënu me dënim unik me 30 vjet burgim.

Duke vepruar lidhur me ankesën e të pandehurit të ushtruar përmes avokatit të tij mbrojtës [REDAKTUE] më 13 korrik 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në lëndën Ap. – Kž. nr. 283/2009, të datës 19 prill 2011.

Pas seancës publike të mbajtur më 25 shtator 2012, në praninë e prokurores së shtetit Judith Tatrai, e të pandehurit [REDAKTUE] të avokatit mbrojtës [REDAKTUE], të përfaqësuesit të autorizuar të palës se dëmtuar [REDAKTUE] (për [REDAKTUE]), të palës së dëmtuar [REDAKTUE] dhe të përfaqësuesit të autorizuar të tij [REDAKTUE] pas këshillimit dhe votimit të mbajtur në të njëjtën ditë,

Më 25 shtator 2012 shpall këtë

## AKTGJYKIM

[FG] [REDAKTUE] vazhdon që nga 22 prilli 2006.

Ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme në lëndën Ap. – Kz. 283/2009, të datës 19 prill 2011, refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme, sipas detyrës zyrtare, e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Supreme Ap. – Kz. nr. 283/2009, të datës 19 prill 2011, sa i përket dënitit. I pandehuri [REDACTED] dënoshet me burgim afatgjatë me 29 vjet.

[FG]


Koha e kaluar në paraburgim nga data 22.4.2006 do të llogaritet.

Ankesa refuzohet në pjesët e tjera të saj.

## ARSYETIMI

### I. HISTORIA E PROCEDURËS

Më 10 janar 2007 Prokurori Publik ngriti aktakuzë kundër [REDACTED] dhe [REDACTED]. Më 6 mars 2007 gjyqtari për konfirmim e konfirmoi aktakuzën kundër të dy të pandehurve.



Më 12 dhjetor 2008 kryetari i asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it lëshoi një aktvendim për caktimin e lëndës te gjyqtarët e EULEX-it.

Më 11 shkurt 2009 nisi shqyrtimi gjyqësor. Aktgjykimi u shpall më 27 mars 2009. [REDACTED] u shpall fajtor për vrasje të rëndë dhe mbajtje në pronësi, në kontroll, në posdim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve dhe u dënuat me dënim unik me 25 vjet e 6 muaj burgim. [REDACTED] u shpall fajtor për shtytje në vrasje të rëndë dhe u dënuat me 20 vjet burgim. Te pandehurit ushtruan ankesë ndaj këtij aktgjykimi. Edhe palët e dëmtuara dhe [REDACTED] ushtruan ankesë ndaj këtij aktgjykimi.

[HG]  
[EF]

[FG]

[GB]

[FG]

[HG]

Më 19 prill 2011 Gjykata Supreme e Kosovës i refuzoi ankesat e të pandehurve me aktgjykim. Edhe ankesat e palëve të dëmtuara përkitazi me të pandehurin [REDACTED] u refuzuan. Ankesat e palëve të dëmtuara përkitazi me [REDACTED] u pranuan dhe dënim i ndryshua në 29 vjet burgim për veprën penale vrasje e rëndë dhe në 2 vjet burgim për veprën penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posdim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Dënim i unik është 30 vjet burgim.

Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar të pandehurit [REDACTED] personalisht më 14 korrik 2011. Mbrojtja ushtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 13 korrik 2011.

[FG]

### II. ANKESA E

Avokati mbrojtës kërkon që të anulohet aktgjykimi dhe lënda të kthehet në rigjykim. Nëse kjo nuk mund të bëhet, aktgjykimi duhet të ndryshohet në atë memurë sa i pandehuri të shpallet fajtor për vepër penale të vrasjes së rëndë në tejkalim të kufijve të

mbrojtjes së nevojshme në përputhje me nenin 147 paragafin 1 nën-paragafin 4 dhe 11 të KPK-së lidhur me nenin 8 paragafin 3 të KPK-së. Në rastin më të pafavorshëm i pandehuri duhet të shpallet fajtor për vepër penale të vrasjes të kryer në gjendje të afektit mendor në përputhje me nenin 148 të KPK-së. Dënim i duhet të ndryshohet sipas rrëthanave si dhe duke marrë parasysh rrëthanat rënduese e në veçanti edhe shëndetin e të pandehurit.

FG

Ankesa e avokatit mbrojtës të [REDACTED] e kundërshton aktgjykimin e Gjykatës Supreme në disa baza. Ai pohon se aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i Gjykatës Supreme kanë vërtetuar gabimisht dhe jo plotësisht gjendjen faktike, se është shkelur kodi penal, dhe se sanksioni penal është shqiptuar gabimisht.

Përshkrimi faktik është vërtetuar gabimisht dhe jo plotësisht andaj lënda duhet të kthehet në Gjykatë të qarkut për t'i vërtetuar faktet në tërësi.

FG

Disa prova që vërtetojnë pafajësinë e [REDACTED] nuk janë administruar si prova në shqyrtim gjyqësor. Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme e injoruan kërkësen e mbrojtjes për rikonstruktim të vendit të ngjarjes.

Po ashtu, numri i të shtënave nga të dyja anët mund të jetë më i madh se ai që Gjykata e Qarkut e ka konstatuar si të vërtetuar. Disa gëzhoja që janë gjetur në vendim e ngjarjes janë shkrepur nga një armë e cila nuk është konfiskuar nga vendi i ngjarjes. Prandaj duhet të ketë qenë edhe një tjetër person që ka shtënë në vendin e ngjarjes, të cilin Gjykata e Qarkut nuk e ka identifikuar. Njashtu, ekspertiza balistike nuk mundi t'i përputhë të gjitha gëzhojat e gjetura me armët e konfiskuara.

FG

Më tutje, është e paqartë nëse ka qenë e mundur të gjuhet nga pozita e të pandehurit drejt vendndodhjes së viktimate, posaçërisht drejt viktimës që ishte në ekskavator në rrugë. Nuk kontestohet se [REDACTED] ka gjuajtur 22 herë drejt ekskavatorit.

FG

Po ashtu, ishte e pamundur të përcaktohen armët me të cilat është shtënë në objektet e lokalit "Cami" si dhe armën me të cilën janë shtënë plumbat që janë gjetur në trupin e [REDACTED]

AXh

FG

Ligji penal është shkelur sepse Gjykata e Qarkut dhe Gjykata Supreme injoruan faktin se [REDACTED] nuk e ka provokuar sulmin, se sulmi i palëve të dëmtuara ishte i pashmangshëm pasi që ata do ta shembnin ndërtesën dhe do të shtinin në drejtim të [REDACTED] dhe se mbrojtja e [REDACTED] ishte proporcionale me sulmin.

FG

FG

FG

FG

FG

Përveç kësaj, nëse Gjykata Supreme vlerëson se mbrojtja e [REDACTED] ishte proporcionale me sulmin atëherë [REDACTED] duhet të shpallet fajtor për tejkalim të mbrojtjes së nevojshme për shkak të traumave të fuqishme ose frikës së shkaktuar nga sulmi, dhe duhet të zbatohet nenin 8 paragrafët 3 dhe 4 e KPK-së. Prandaj [REDACTED] është dashur të lirohet në përputhje me nenin 390 paragafin 1 nën-paragafin I të KPPK-së.

Paligjshmëria e sanksionit penal rrjedh nga vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike dhe nga shkeljet e ligjit penal.

### III. PËRGJIGJA E PROKURORISË

Prokurori i Shtetit propozon të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Supreme.

Ankesa thjesht i përsërit argumentet e ankesës së mëparshme dhe nuk ofron asnjë argument të ri.

Gjetjet faktike të Gjykatës së Qarkut janë të bazuara në ekzaminim dhe vlerësim të plotë të provave, dhe Gjykata Supreme me të drejtë i ka mbështetur këto gjetje. Po ashtu, nga këto gjetja janë nxjerrë disa konkluzione të arsyeshme. Pra është arritur përfundim i drejtë se i akuzuar [REDAKTUE] ka shtënë i pari. Këtë përfundim e mbështete edhe [REDAKTUE] me pranimin e tij para prokurorisë publike.<sup>1</sup>

Prokurori i Shtetit njashtu kujton parimin e diskrecionit të gjykatë së shkallës së parë lidhur me vlerësimin e provave se Gjykata Supreme nuk do të ndërhyjë përderisa aktgjykimi i ankimuar nuk i shkel rrregullat e logjikës dhe të menduarit praktik.

Sa i përket pretendimit të mbrojtjes së nevojshme, prokurori i shtetit pohon se është vërtetuar se [REDAKTUE] ka shtënë i pari dhe bën të ditur se mbrojtja e nevojshme nuk vlen për agresorin. Veprimet e [REDAKTUE] janë cilësuar drejt juridikisht.

Sa i përket dënimit prokurori i shtetit mendon se dënnimi është i drejtë. Ajo bën të ditur se Gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat konkrete për përcaktimin e dënimit dhe i ka vlerësuar drejt ato.

### IV. GJETJET E GJYKATËS

#### A. Pranueshmëria e ankesës

1. Gjykata Supreme gjen se ankesa e ushtruar në emër të të pandehurit është paraqitur brenda afatit ligjor prej 15 ditësh siç përcaktohet me nenin 398 të KPK-së, prandaj është e ushtruar me kohë. Ankesën e ka ushtruar avokati mbrojtës, si person i autorizuar. Prandaj ankesa është e pranueshme.
2. Mirëpo, Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar. Koleksi tani do t'i vlerësojë të gjitha argumentet e ngritura në ankesë nga ana a mbrojtjes.

#### B. Vërtetimi i gjendjes faktike

<sup>1</sup>Dëshmia e [REDAKTUE] para prokurorisë publike më 10 maj 2006

3. Gjykata Supreme kujton se është prerogativë e kolegit të bëjë vlerësimin e provave të paraqitura edhe kur ato janë kundërshtuese. Për arsyen e kolegji, me martjen e provave drejtëpërdrejt, është në pozitë më të mirë për të vlerësuar besueshmérinë e dëshmitarëve dhe/ose ekspertëve. Është detyrë e Gjykatës Supreme të përcaktojë a ka e bërë kolegi këtë vlerësim drejt. Rishikimi i Gjykatës Supreme të vlerësimit të kolegit pra është i kufizuar në pyetjet se a janë eksploruar me kujdes faktet, e janë të pranueshme provat e paraqitura dhe a është vlerësimi bindës. logjik dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka diskrecion mbi vlerësimin e provave se Gjykata Supreme nuk do të ndërhyjë përderisa aktgjykimi i ankumuar nuk i shkel rregullat e logjikës dhe mendimit praktik. Gjykata Supreme bën vetëm ri-vlerësimin e provave nëse konstaton se vlerësimi i trupit gjyques është i gabueshëm.

4. [REDAKTUE] pretendon se disa prova që vërtetojnë pafajësinë e tij nuk janë administruar si prova në shqyrtim gjyqësor. Ai nuk specifikon cila prova nuk i ka administruar gjykata.

5. Gjykata Supreme në aktgjykimi e vet më 19 prill 2011 pohon se "... Gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha provat në dispozicion, në hollësi si dhe një nga një, dhe qartë i ka bazuar gjetjes e veta dhe vendimin e vet në këto prova."<sup>2</sup>

6. Gjykata Supreme vëren se avokati mbrojtës ka të drejtë të kërkojë të merren parasysh provat në shqyrtim gjyqësor. Më 11 shkurt 2009 avokati mbrojtës [REDAKTUE] kishte kërkuar qe shkresat e lëndës kundër [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] të merren si pjesë e provave pasi që ata në ditën kritike ishin akuzuar për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Trupi gjyques e kishte refuzuar kërkesën. Mirëpo, [REDAKTUE] dhe [REDAKTUE] ishin dëgjuar si dëshmitarë në shqyrtim gjyqësor kështu qe avokati mbrojtës ka pasur mundësinë t'i qartësojë të gjitha çështjet lidhur me përfshirjen e tyre. Më tutje, më 19 shkurt 2009 avokati mbrojtës [REDAKTUE] ka kërkuar të dëgjohet eksperti i mjekësisë ligjore dhe të bëhet rikonstruktimi i vendit të ngjarjes. Më 4 mars 2009 Gjykata e dëgjoi ekspertin e mjekësisë ligjore [REDAKTUE]. Pas shkresat e lëndës përbajnjë një numër të madh të fotografive të vendit të ngjarjes, rikonstruktimi i vendit të ngjarjes nuk ishte i domosdoshëm, Përveç kësaj, më 4 mars 2009 trupi gjyques e ka refuzuar kërkesën e avokatit mbrojtës për t'i marrë parasysh dokumentet nga shkresat e lëndës kur në fillim kur u dëgjua lënda pasi që sipas KPPK-së një procedurë e tillë nuk lejohet.

7. Prandaj Gjykata Supreme nuk gjen se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka administruar provat në dëm të avokatit mbrojtës.

8. Vlen të përmendet se [REDAKTUE] nuk e mohon se ka shtënë prej objektet e lokalit "Cami". Përkundrazi, ai ka deklaruar se "Pasi ky person ka lëshuar gërmuesin në asfalt unë kam hyrë në shtëpinë time dhe kam marrë armën – automatike të llojit AK-47, ... në

<sup>2</sup> Aktgjykimi i datës 19 prill 2011, faqe 17 e versionit në gjuhën angleze

fillim kam shtënë pa ndërprerje nja 5-6 herë lart nga dritarja e objektit "Cami" ...<sup>3</sup> Vlen po ashtu të përmendet se ai nuk thitë se ka qenë dikush tjetër me të në objektet e lokalit "Cami".

9. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut pohon se "Shpërthimet e të shtënave filluan prej objektit të zënë nga familja [REDACTED] kjo është e qartë."<sup>4</sup> Gjykata Supreme ka pohuar se "Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar provat plotësisht ... Duke u bazuar në të gjitha provat Gjykata ka gjetur se [REDACTED] ishte ai që ka hapur zjarr, pra i armatosur me pushkë automatike dhe se ai ka shtënë disa rafalë kur palët e dëmtuara as që kanë mundur të reagonin ..." dhe kështu e ka pranuar vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë.<sup>5</sup> Gjykata Supreme nuk është bindur të bëjë një vlerësim ndryshtë të ngjarjeve.

10. [REDACTED] më tej pretendon se dikush tjetre ka mundur t'i shkrepë plumbat që [REDACTED] ia shkaktuan vdekjen.

11. Aktgjykimi i shkallës së parë thotë se "Dëshmitarë të tjerë ... konfirmojnë se ... [REDACTED] u qëllua gjersa ishte i ulur dhe nuk kishte mundësi të ikë i zënë në besasi."<sup>6</sup>

12. Gjykata Supreme bën të ditur se është e pakontestueshme që [REDACTED] ka shtënë 57 herë nga objektet e lokalit "Cami". Të gjithë dëshmitarët pohojnë se ne kafene është qëlluar nga lokalit Cami. Dëshmitari [REDACTED] dëshmoi se "Dëgjova të shtëna që vinin nga ana e kundërt. Nuk e dija se çfarë po ndodh. Derisa hyra në kafene – pasi isha afér derës – e pashë doktorin dhe njeriu i moshuar tanimë ishte qëlluar."<sup>7</sup> Dëshmitari [REDACTED] duket se sugjeron se të shtënat po ashtu janë shkrepur nga shtëpia e [REDACTED]. Këtë nuk e mbështesin dëshmitarët e tjerë e as policia nuk ka siguruar asnjë gezhoje nga kjo shtëpi. Përveç dëshmitarit [REDACTED] asnjë dëshmitar tjetër nuk pohon se në kafene është shtënë nga drejtime të tjera. Përkundrazi, kur është pyetur "A keni parë apo dëgjuar dikë duke gjuajtur jo nga ana e kundërt por nga ana ku gjendet kafeneja juaj?" dëshmitari [REDACTED] deklroi "Jo."<sup>8</sup> Prandaj Gjykata Supreme pajtohet me konkluzionin e gjykatës se shkallës së parë se [REDACTED] ishte vrarë nga plumbat e shkrepur nga [REDACTED].

13. S ai përket pretendimit se nuk është e qartë se a ka qenë e mundur që të shtënat të vinin nga pozita e të pandehurit [REDACTED] ka vendndodhja e viktimate, Gjykata Supreme bën të ditur se nga fotografia 306 e raportit të vendit të ngjarjes dhe nga fotografia 14 e bashkëngjitur në "raportin shtesë" është e qartë se të shtënat kanë mundur të shkrepën nga pozita e të pandehurit [REDACTED] ka vendndodhja e viktimate.

### C. Shkeljet e pretenduara të ligjit penal

<sup>3</sup> Prosesverbal i shqyrtimit në Prokurorinë Publike të Qarkut, i datës 10 maj 2006, faqe 4 e versionit në gjuhën angleze.

<sup>4</sup> Aktgjykimi i datës 27 mars 2009, faqe 13 e versionit në gjuhën angleze.

<sup>5</sup> Aktgjykimi i datës 19 prill 2011, faqe 11 e versionit në gjuhën angleze.

<sup>6</sup> Aktgjykimi i datës 27 mars 2009, faqe 12 e versionit në gjuhën angleze

<sup>7</sup> Prosesverbal i shqyrtimit gjyqësor, më 4 mars 2009, faqe 3 e versionit në gjuhën angleze

<sup>8</sup> Prosesverbal i shqyrtimit gjyqësor, më 4 mars 2009, faqe 9 e versionit në gjuhën angleze

FG

14. [REDACTED] pretendon se veprimet e tij mund të kategorizohen si tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme. Vlen të theksohet se ai nuk e mohon se ka shtënë nga objektet e lokalit "Cami". Po ashtu vlen të përmendet se ai nuk pohon se ka qenë dikush tjetër me të në objektet e lokalit "Cami".

15. Gjykata Supreme rikujton se në përputhje me nenin 8 paragrafin 2 të KPPK-së "Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zembrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të pashmangshëm ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë proporcional me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi." Në vazhdim parografi 3 i këtij neni thotë "Disproporcion i ndërmjet sulmit dhe zembrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme."

16. Së pari, Gjykata Supreme bën të ditur se KPK-ja nuk e njeh mbrojtjen e pronës si bazë për mbrojtjen e nevojshme pasi që nen 8 i KPK-së thotë "...sulmin ndaj vetes ose ndaj një personi tjetër..."

FG

FG

FG

17. Së dyti, siç u përmend më lart, është e qartë se [REDACTED] ishte i pari që hapi zjarr. Përveç kësaj, [REDACTED] ka deklaruar se "Pasi ky person ka lëshuar gërmuesin në asfalt unë kam hyrë në shtëpinë time dhe kam marrë armën, ... dhe me të njëjtën armë automatike kam hyrë menjëherë në objektin "Cami" nga hyrja e prapme ... në fillim kam shtënë pa ndërprerje nga 5-6 herë lart nga dritarja e objektit "Cami"..."<sup>9</sup>. Prandaj është e qartë se nuk kishte rrezik të pashmangshëm për jetën e [REDACTED] po të bëhej shembja. Përkundrazi, ai ishte shumë i vetëdijshëm për kontestin pronesor. Po ashtu në ditën kritike ai pati kohë të largohej nga objekti, ta marrë armën e tij, të kthehej në objekt përmes derës së prapme dhe të gjuajë në ekskavatorin që sapo ishte vendosur poshtë në tokë.

18. Prandaj institucioni i mbrojtjes së nevojshme nuk vlen, dhe prandaj mbrojtja e nevojshme as që mund të tejkalohet, përkitazi me veprimet e [REDACTED]

FG

19. Përndryshe, [REDACTED] ka pohuar se ka vepruar në gjendje të afektit mendor.

FG

AXh

20. Gjykata Supreme rikujton se në përputhje me nenin 148 të KPK-së "Kushdo që tjetrin e privon ngajeta në gjendjen e afektit mendor, i vënë pa fajin e tij në gjendje të tronditjes së fortë mendore të shkaktuar nga sulmi, keqtrajtimi apo fyerja e rëndë nga ana e personit të vrarë, dënohet ..."

VB

FG

BB

21. Gjykata Supreme bën të ditur se në shkresa të lëndës nuk ka shenja të sulmit, keqtrajtimi apo fyerjes së rëndë nga ana e [REDACTED] ose [REDACTED] ndaj [REDACTED] pasi që ata ishin ulur në kafenenë përballe lokalit "Cami" duke pirë kafe. [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] nuk ishin duke e sulmuar, e keqtrajtuar e as duke e fyér [REDACTED] pasi që ata ishin duke e ekzekutuar të drejtën e tyre si pronarë të ligjshëm të asaj prone. [REDACTED] dhe [REDACTED]

H-H

XhS

<sup>9</sup> Procesverbal i shqyrtimit ne Prokurorinë Publike te Qarkut, i datës 10 maj 2006, faqe 4 e versionit në gjuhën angleze

ishin në vendin e ngjarjes vetëm rastësish. [REDACTED] madje nuk ishte as në vendin e ngjarjes por ishte në shtëpinë e saj. Dhe në fund, [REDACTED] ishte polic në detyrë të mbikëqyrjes së trafikut gjatë shembjes. Asnjëri prej tyre nuk paraqiste rrezik për [REDACTED]

AJ

IH

FG

22. Neni 71 paragrafi 2 i KPK-së përcakton shqiptimin e dënimit unik. Nën-paragrafi 1 i këtij neni thotë se "Nëse për ndonjëren prej veprave penale gjykata ka shpallur dënimin me burgim afatgjatë, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim."

23. I pandehuri [REDACTED] u dënuu me burgim afatgjatë me 29 vjet për kryerje të veprës penale të vrasjes së rëndë dhe me burgim me 2 vjet për vepër penale mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve. Gjykata shqiptoi një dënim unik me 30 vjet burgim.

24. Gjykata Supreme bën të ditur se kjo shkel nenin e lartpërmendur të ligjit penal në dëm të të akuzuarit.

25. Prandaj Gjykata Supreme ka ndryshuar dënimin siç përmendet në dispozitiv.

#### D. Dënimi

26. Siç ka shënuar gjykata e shkallës së parë neni 64 paragrafi 1 i KPK-së përcakton caktimin e dënimit. Aktgjykim po ashtu pohon se kufijtë e përcaktuar me ligj për veprën penale të vrasjes së rëndë janë dënim me së paku dhjetë vjet burgim ose burgim afatgjatë që do të thotë burgim me njëzet e një deri dyzet vjet.<sup>10</sup>

27. Aktgjykim po ashtu diskuton përfaktoret rëndues dhe lehtësues që gjykata e shkallës së parë i ka marrë parasysh.<sup>11</sup>

28. Gjykata Supreme gjen se "... gjykata e shkallës së parë ka konsideruar drejt kufijtë e dënimit siç parashihet me dispozitat të fuqi të KPK-së.... ka bërë shpjellime lidhur me veprimet e të akuzuarit [REDACTED] të cilave gjykata i referohet si të neveritshmë, rrëqethëse dhe të ulëta, si dhe ka dhënë shpjegime të duhura përkitazi me këto aspekte".<sup>12</sup> Gjykata Supreme po ashtu i referohet vlerësimi të Gjykatës së Qarkut për brutalitetin e jashtëzakonshëm të kryerjes së këtij krimi dhe rrëthanave lehtësuese. Megjithatë, Gjykata Supreme gjen se "... dënim i shqiptuar ndaj kryerësit kryesor [REDACTED] është tepër i butë, duke marrë parasysh faktin se [REDACTED] jo vetëm se ka vrarë dy njerëz të pafajshëm në rrugë, por përvëç kësaj at ka rrezikuar jetët dhe ka dëmtuar rëndë shëndetin e shumë njerëzve të tjerë që ishin aty përreth, kur filloj të shtënat. Për më shumë, ai i ka hedhur tri granata të dorës të cilat përfat të mirë nuk shpërthyen, por që kanë rrezikuar seriozisht jetët dhe shëndetin trupor të shumë njerëzve në atë vend dhe do

FG

FG

FG

<sup>10</sup> Aktgjykim i datës 27 mars 2009, faqe 25 e versionit në gjuhën angleze

<sup>11</sup> Aktgjykim i datës 27 mars 2009, faqe 25-26 e versionit në gjuhën angleze

<sup>12</sup> Aktgjykim i datës 19 prill 2011, faqe 18 e versionit në gjuhën angleze

*të kishin shkaktuar një masakër po të kishin shpërthyer, e që ishte edhe qëllimi i të akuzuarit*<sup>13</sup> dhe ndryshoi dënimin.

29. Gjykata Supreme pajtohet me vlerësimin e mëparshëm të Gjykatës Supreme. Prandaj Gjykata Supreme konsideron se dënnimi me 29 vjet burgim për veprën penale të vrasjes së rëndë është si dhe proporcional me rëndësinë e veprës penale dhe rrëthanat konkrete në këtë lëndë specifike. Siç u sqarua më lart në paragrafët 22 - 25 ky është po ashtu dënnimi unik.

## V. PËRFUNDIMI

1. Gjykata Supreme gjen se ankesa është e pabazuar.
2. Gjykata Supreme *ex officio* e ndryshon aktgjykimin e Gjykatës Supreme përkitazi me dënnimin si në dispozitiv. Gjykata Supreme nuk njeh *ex officio* asnë shkelje tjetër të ligjit (Neni 415 paragrafi 1 i KPPK-së) që nuk janë objekt shqyrtimi i ankesës së mbrojtjes.
3. Duke u bazuar në të gjitha arsyet e lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv .

**Sot, më 25 shtator 2012.  
Api.-Kži. Nr. 6/2011**

**Kryetar i kolegjit**

Martti Harsia

**Procesmbajtëse**

Noora Aarnio

**Anëtae i kolegjit**

Anne Kerber

**Anëtar i kolegjit**

Avdi Dinaj

<sup>13</sup> Aktgjykimi i datës 19 prill 2011, faqe 18 e versionit në gjuhën angleze.

**Anëtare e kolegjit**

Valdete Daka

**Anëtar i kolegjit**


Republika e Kosovës



Republika Kosovo

Sykri Sulejmani

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAÇNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

  
Punëtori i autorizuar  
Ovlašcenj radnik